**VENDIM**
**Nr.51, datë 5.7.2010**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "WENERG" SHA**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa "a", nenit 9 dhe 13 pika 1, germa "a" të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", neni 5 pika 1 germa "a" neneve 13 dhe 14 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 5.07.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "WENERG" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson tërësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

-Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);

-Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);

-Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);

-Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1.Licencimin e shoqërisë "WENERG" sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga "Hidrocentrali Dardhë" për një afat 30- vjeçar

2.Shoqëria të fillojë ushtrimin e aktivitetit për prodhimin e energjisë elektrike në përputhje me afatet e përcaktuara në kontratën e koncesionit.

3.Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
**Bujar Nepravishta**